



BASHKIA TIRANË

Nr. prot. 17540, Dt. 08.06.2016



FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE
URBANISTIKËS

Nr. prot. 135, Dt. 08.06.2016

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

MIDIS

BASHKISË TIRANË

DHE

FAKULTETIT TË ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS

Kjo marrëveshje bashkëpunimi ka për qëllim rregullimin e partneritetit midis:

- **Bashkisë Tiranë** (në vijim Bashkia), dhe
- **Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës** (në vijim FAU)

Fusha e veprimit të kësaj marrëveshje përcaktohet nga:

- kuadri i legjislacionit në fuqi dhe programe të Bashkisë për arritjen e objektivave të saj brenda hapësirës së përgjegjësive shtetërore në drejtim të zhvillimit urban të territorit që mbulon kjo Bashki,
- si edhe nga vullneti, i shprehur nëpërmjet këtij protokolli, i FAU si institucion i arsimit të lartë në fushën e arkitekturës dhe urbanistikës, për të kontribuar në arritjen e këtyre objektivave.

Objektivat dhe fushat përkatës të bashkëpunimit do të jenë si vijon:

I. OBJEKTIVAT E BASHKËPUNIMIT

Aktivizimi i bashkëpunimit në fushën e kërkimit shkencor dhe realizimit praktik të zhvillimit të qendrueshëm të Bashkisë së Tiranës në disiplinat e mëposhtme:

1. Planifikim urban, kontrolli i zhvillimit të territorit, ndërtimi, zhvillimi i turizmit;

2. Evidentimi dhe ruajtja e trashëgimise kulturore;
3. Ruajtja e ambientit dhe e burimeve natyrore;
4. Kontribut teknik në vendimmarrje;
5. Realizimi i praktikave profesionale.

Bashkëpunimi do të realizohet mbi bazën e barazisë dhe të përfitimit reciprok me mundësinë e zgjerimit në të ardhmen, të fushave të tjera të bashkëpunimit bazuar në fondet (nëse janë disponibel) si në aftësinë dhe eksperiencën e fituar nga punonjësit e të dy institucioneve.

II. PLANIFIKIMI URBAN, KONTROLLI I ZHVILLIMIT, NDËRTIMI, ZHVILLIMI I TURIZMIT

- Bashkia është e gatshmet të konsultohet gjatë procesit të hartimit dhe të marrë mendimin e FAU për aktet ligjore e administrative, i cili do të iniciohet në fushën e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit, administrimit të tokës, turizmit, legalizimit të objekteve dhe zonave informale, si dhe projektimit, ndërtimit, supervizionit të objekteve të ndryshme dhe infrastrukturës. Zbatimit të kushteve teknike në projektim e zbatim, procedurave të kontraktimit e marrjes në dorëzim të objekteve.
- FAU për sa më sipër është i gatshëm, që në interes të zhvillimit të qëndrueshëm, të respektojë vullnetin e Bashkisë në këto iniciativa dhe të kontribuojë duke dhënë mendim, bazuar në eksperiencën teknike e zhvilluese që disponon në këto fusha.
- Po në këtë kuadër FAU është i gatshëm të punojë bashkërisht për propagandimin e pasojave negative dhe rreziqet që sjell informaliteti në ndërtim veçanërisht në zonat bujqësore dhe në zonat e mbrojtura.

III. EVIDENTIMI DHE RUAJTJA E TRASHËGIMISE KULTURORE

Palët angazhohen për aktivizimin e bashkëpunimit në fushën e trashëgimise së veprave arkitektonike dhe urbane specifikisht në disiplinat e mëposhtme:

- a. Restaurimi dhe ruajtja e monumenteve të arkitekturës dhe i siteve arkeologjike;
- b. Rilevimi dhe paraqita e monumenteve të arkitekturës dhe siteve arkeologjike;
- c. Evidentimi dhe katalogimi i monumenteve dhe i siteve arkeologjike.

IV. RUAJTJA E AMBIENTIT DHE E BURIMEVE NATYRORE

Palët angazhohen për zbatimin e programeve dhe projekteve të përbashkëta mbi zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, ruajtjen e zonave natyrore dhe ekosistemit. Specifikisht bashkëpunimi do të përqendrohet në disiplinat e mëposhtme:

- a. Zhvillimin e qëndrueshëm të territorit;

- b. Ruajtja e energjise ne ndertesa;
- c. Problemet e transportit dhe te trafikut urban e rural;
- d. Ruajtja dhe zhvillimi i ekosistemeve, flores dhe faunes.

V. KONTRIBUT TEKNIK NË VENDIMMARRJE

- Bashkia është e gatshme të kërkojë kontributin e specialistëve të FAU, në rastet kur e gjykon të vlefshme dhe/ose të domosdoshme, në hartimin apo vlerësimin e projekt-akteve dhe projekteve te zhvillimit që shqyrtohen nga ajo përpara se të miratohen në instancat përkatëse.
- Bashkia angazhohet të informojë për mbledhjet e Këshillit të Territorit, kur shqyrtohen çështje ku vlerësohet se prezenca e përfaqësuesve të FAU është e nevojshme apo e domosdoshme për të arritur transparencën në vendimmarrje.
- FAU angazhohet të ndihmojë dhe t'u ofrojë kontribut teknik të gjitha instancave vendimmarrëse, me kërkesën e tyre, duke vënë në dispozicion specialistët e saj më të mirë, në rastet e shqyrtimit të studimeve e projekteve për zhvillimin e territorit, ndërtimin dhe turizmin.
- FAU angazhohet të kontribuojë me specialistët e tij më të mirë në çdo grup pune që kryen aktivitet në fushën e veprimit të FAU dhe atëherë kur do të gjykohet e nevojshme nga Bashkia.

VI. REALIZIMI I PRAKTIKAVE PROFESIONALE

Qëllimi i programit te praktikes profesionale është qe ta kualifikoje dhe praktikojte profesionistet e rinj qe studioje ne FAU ne drejtim te zhvillimit te qendrueshem dhe problematikave konkrete qe dalin prej tij.

Disa nga synimet e këtij programi janë:

- T'u ofrojmë studenteve një mundësi praktike, eksperience pune për te investuar ne fillimin e karrierës se tyre profesionale ne te gjitha aspektet e punës pranë Bashkisë Tiranë. T'u sigurojmë studenteve praktikant një mundësi për te fituar eksperience ne përfshirjen e ne planet e veprimtarive për zhvillimin e territorit te Bashkisë me qëllimeve mbledhjen e te dhënave studimore dhe hartimin e projekteve te ndryshëm ne këtë sektor.

Studentet qe do te pranohen te kryejnë praktiken profesionale mund te jene studente te vitit te katërt te cilët ndjekin studimet ne Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës ne dege te ndryshme te tij.

Studenti praktikant do te jete përgjegjës për te përmbushur te gjitha kërkesat qe rrjedhin nga kjo marrëveshje. Disa nga elementet kryesore te marreveshjes janë:

- a. Raportimi pranë Bashkisë Tiranë konform datave e aktiviteteve të marra përsipër nga programi i punës së praktikës mësimore.
- b. Kryerjen e detyrave me nivel profesional dhe përgjegjësi të lartë.
- c. Hartimi e dorëzimi, në fund të periudhës së programit të praktikës profesionale, i një raporti përfundimtar mbi punën e kryer, me qëllim vlerësimin me shkrim nga drejtuesit e institucionit për realizimin e detyrave dhe cilësinë e punës së kryer prej tij.

VII. TË TJERA

- Bashkia dhe UPT shprehin vullnetin se do të bashkëpunojnë për të sjellë rezultate pozitive në drejtim të partneritetit dhe realizimit të objektivave për zhvillimin e integruar të Bashkisë së Tiranës dhe do të punojnë për realizimin e përsosjen e kontakteve dhe marrëdhënieve midis palëve.
- Palët angazhohet se do të marrin pjesë dhe do të japin kontribut reciprok nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në aktivitetet tematike kryesore që do të organizojnë si Bashkia ashtu dhe FAU, të cilat kanë si objektiv zhvillimin urban, zhvillimin e turizmit dhe partneritetin Publik-Privat në Bashkinë e Tiranës.
- Palët angazhohen për zbatimin e programeve dhe projekteve të përbashkëta zhvillimore si dhe shkëmbim informacioni dhe materiali dokumentar, i cili do të përdoret vetëm për qëllimet e përcaktuara në marrëveshje.
- Palët angazhohen gjithashtu për organizimin dhe sponsorizimin e konferencave, seminareve, workshop-eve, ekspozitave, botimeve të përbashkëta që të kenë si objektiv zhvillimin e qendrueshëm të Bashkisë Tiranë.

VIII. KOMUNIKIMI

Palët angazhohen të mbajnë linja të hapura komunikimi në të gjitha nivelet dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për punën e tyre.

IX. KOHËZGJATJA E MARRËVESHJES

Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj dhe do të zgjasë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare. Ajo do të rinovohet automatikisht nëse asnjëra prej palëve nuk njofton me shkrim palën tjetër.

X. KUFIZIMET E MARRËVESHJES

Të dy palët bien dakord që realizimi i veprimtarive me interes të përbashkët të kryhet në vartësi të burimeve dhe potencialit të disponueshëm nga secili institucion. Për çdo veprimtari konkrete që përputhet me frymën e kësaj marrëveshje, palët kanë të drejtë të formulojnë e nënshkruajnë marrëveshje të veçanta bashkëpunimi dhe partneriteti.

XI. NDRYSHIMI, AMENDIMI DHE REVOKIMII MARRËVESHJES

Çdo pikë e kësaj marrëveshje mund të ndryshohet, të amendohet ose të revokohet në çdo kohë, pas një konsultimi dhe mirëkuptimi reciprok ndërmjet dy institucioneve.

XII. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Në rast mosmarrëveshjeve të dyja palët i zgjidhin ato nëpërmjet negocimit dhe me mirëkuptim.

XIII. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

- Çdo ndryshim i kësaj marrëveshje do të aprovohet me shkrim midis palëve.
- Kjo marrëveshje përbën të vetmen marrëveshje ndërmjet palëve, dhe të gjitha dokumentet, nëse ka, të shkëmbyera më parë ndërmjet tyre, mbeten pa efekt ligjor nëse nuk janë të konfirmuara dhe të sigluara zyrtarisht në mënyrë institucionale.
- Çdo specifikim i mëtejshëm i kësaj marrëveshje rregullohet me anekse të cilat bëhen pjesë e kësaj marrëveshje pasi siglohen nga të dyja palët.
- Kjo marrëveshje është hartuar në gjuhën shqipe, në dy kopje dhe është lexuar, kuptuar, dhe nënshkruar me vullnetin e lirë të tyre.


Nënshkruar në Tiranë, më 07 / 06 / 2016

Për

Bashkinë Tiranë

KRYETARI

Z. Erion VELIAJ



Për

Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës

DEKANI

Prof. Asoc. Dr. Florian NEPRAVISHTA

